

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Kujtimi me përmendje / *edh-Dhikr* / الذِّكْر

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"وَاذْكُرْ رَبَّكَ إِذَا نَسِيتَ"

"Dhe kujto / përmend Zotin tënd pasi të harrosh." (el-Kehf, 24)

Kjo do të thotë t'i harrosh të tjerët, pastaj ta harrosh vetveten në përmendjen që bën, pastaj ta harrosh përmendjen që ti bën gjatë përmendjes së Tij, pastaj, në të parët e përmendjes që Ai ta bën ty, të harrosh çfarëdo përmendje tjetër.¹

Dhikri ose përmendja këtu ka të bëjë me largimin e shkujdesjes dhe harresës. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është përmendja e dukshme, që përfshin lavdërimin, lutjen, dhe kujdesin.²

¹ Kjo mund të jetë prej konkluzioneve (*ishaaraat*) të ajetit, jo kuptimi i tij i drejtpërdrejtë, që ka të bëjë me harresën e pejgamberit ﷺ që të thoshte '*inshaAllah*', kur kurejshët e pyetën për shpirtin dhe ai u premtoi se do t'u përgjigjej. Ajo çfarë shejhu (el-Harawi) mendon këtu është se, kur personi kujton Allahun me përmendje, nuk duhet të lejojë asgjë t'ia zhvendosë vëmendjen nga të parët e plotë të hyjnore (shuhuud), përfshirë këtu edhe vetëdijen për vetveten. Atëherë ai nuk do ta shohë aktin e vet të përmendjes në dobi të të parit e Zotit, pas çka të parët e përmendjes që Ai i bën atij do ta parandalojë që të shohë ndonjë gjë tjetër. Kjo përkon me parapëlqimin e shejhut (el-Harawit) të shkallës së *fanaa*-s (vetasgjësimi) mbi të gjitha shkallët e tjera. Ju lusim t'i shihni diskutimet e mëhershme rreth kësaj shkalle. Shkalla e *bekaa* (mbetjes) nëpërmjet Allahut, me Allahun e për Allahun është më e lartë, më e sigurt, më e vërtetë, dhe në përputhje me rrugën e gjeneratës së parë (të besimtarëve). Mirëpo, ndrydhja e egos (*nefsit*) që theksohet në shkallën e *fanaa*-s - jo shpërbërja e plotë e egos - është parakusht për shkallën (stacionin) e *bekaa*.

² Përmendja e dukshme këtu, siç thekson Ibn el-Kajjim në *Medaarixh*, është përmendja (e vëmendshme) me gjuhë. Lavdërimi i Allahut, kërkimi i ndihmës së Tij,

Niveli i dytë është përmendja e fshehtë dhe ka të bëjë me largimin e plogështisë, mbetjen në *shuhuud* (të parët e hyjnore), dhe bashkimin në dialogun intim.³

Niveli i tretë është përmendja e njëmendtë, që është të parët e përmendjes që i Vërteti ta bën ty, heqja e të parit të përmendjes që ti bën, dhe njohja e pavërtetësisë së atij që përmend Zotin ndërsa mbetet (vetëm) në përmendjen që bën (duke mos parë vetëm të krijuarit e përmendjes së tij nga Zoti).⁴

respektimi i të drejtave të Tij dhe mirësjellja me Të (kujdesi) është mënyra nëpërmjet të cilës arrihet ky nivel.

³ Tash zemra është e qëndrueshme në përmendje. Edhe atëherë kur gjendet mes turmave të njerëzve dhe mes ngjarjeve, ajo nuk pushon së qeni me Zotin dhe nuk pushon së biseduari me Të.

⁴ Prapë, niveli i tretë ka të bëjë me *fanaa* (vetasgjësim). Shqetësimi i shejhut është se këtu ende s'është shpërbërë egoja e atij që vazhdon të jetë i vetëdijshëm për aktin e përmendjes që e bën. Siç kemi diskutuar më herët, ka disa kuptime të arsyeshme në shkallën e *fanaa*-s. Fundja, ne s'kemi qenë gjë. Po të mos ishte për Të, nuk do të ekzistonim; po të mos ishte vullneti i Tij dhe të krijuarit e Tij të përmendjes sonë, ne nuk do ta përmendnim. Kjo është ajo që, kur Imam Ibn el-Kajjim pyeti Imam Ibn Tejmijen lidhur me shpjegimin e faktit se si e bën të kënaqur Allahun përmendja që ne i bëjmë Atij dhe si bën që një krijesë që ka fund, me një fillim të qartë, të ndikojë në krijuesin e pafund, të përjetshëm, që s'ka fillim e fund, ai (Ibn Tejmije) sqaroi se ishte vullneti i Allahut që përmendja jonë ta kënaqë Atë dhe Ai është i cili na krijoi ne dhe po ashtu krijoi përmendjen tonë që ia bëjmë Atij, kështu që gjithçka kthehet tek Ai.